
KANALET EKONOMIKE TË NDIKIMIT TË HUAJ NË MAQEDONINË E VERIUT

STUDIM RASTI



SHKUP, 2026

Titulli origjinal:
„Економски канали на странско влијание во Северна Македонија”
- студија на случај

Botues:
Instituti për Studime të Komunikimit
rr. Jurij Gagarin 17/1-1, Shkup
www.iks.edu.mk

Për botuesin:
Dr. Zhaneta Trajkoska

Autor:
Instituti për Studime të Komunikimit

Redaktor:
Bojan Georgievski

Përkthim nga maqedonisht në shqip:
Shenasi Jahiu

Edicioni:
ResPublica

Lekturë:
Simona Gruevska-Maxhoska

Dizajni grafik:
Zoran Kardula

Rregullimi grafik:
Dejan Joveski

Vendi dhe data:
Shkup, 2026

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

327.8:338.246.2(497.7)(047.3)

KANALET ekonomike të ndikimit të huaj në Maqedoninë e Veriut [Електронски извор] : studim rasti / [përkthim nga maqedonisht në shqip Shenasi Jahiu]. - Shkup : Instituti për Studime të Komunikimit, 2026. - (Edicioni ResPublica)

Начин на пристапување (URL):
https://respublica.edu.mk/wp-content/uploads/2026/03/ekonomski-kanali-na-stransko-vlijanie-vo-rsm_al.pdf.
- Превод на делото: Економски канали на странско влијание во Северна Македонија. - Текст во PDF формат, содржи 14 стр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 14.05.2026. - Библиографија: стр. 13-14

ISBN 978-608-4805-81-6

а) Странски влијанија -- Економски инструменти и стратегии -- Македонија -- Истражувања

COBISS.MK-ID 68795141

1. HYRJE

Manipulimi i informacionit dhe ndërhyrja e huaj (FIMI) është një aktivitet i organizuar, i qëllimshëm dhe shpesh i fshehtë nga aktorë shtetërorë ose jo-shtetërorë që synojnë manipulimin e mjedisit të informacionit me qëllim arritjen e avantazhit politik, ushtarak, ekonomik ose shoqëror. FIMI më shpesh shoqërohet me fushata dezinformimi, manipulim zgjedhor, sulme kibernetike dhe operacione të fshehta të inteligjencës. Megjithatë, vitet e fundit, institucionet evropiane dhe kërkimet akademike kanë theksuar gjithnjë e më shumë se instrumentet ekonomike të pushtetit përfaqësojnë një nga shtyllat qendrore të strategjive të ndikimit, d.m.th. ato e njohin FIMI-n si një fenomen shumëdimensional që shkon përtej fushës së informacionit dhe përfshin mekanizma ekonomikë, juridikë dhe institucionalë.

Maqedonia e Veriut nuk është e përjashtuar nga trende të tilla. Kjo thuhet në studimin Ndërhyrja e huaj dhe manipulimi i informacionit në Maqedoninë e Veriut, në të cilin thuhet se "Edhe pse pak i adresuar dhe trajtuar në Maqedoninë e Veriut, ndërhyrja e huaj dhe manipulimi i informacionit shpesh kanalizohet përmes kanaleve ekonomike që përfshijnë: shfrytëzimin e investimeve strategjike, ndihmën ekonomike, kreditë dhe përdorimin e lirisë së tregut për të fituar ndikim mbi median, institucionet akademike ose elitat politike, si dhe përdorimin e varësisë energjetike ose lidhjeve tregtare për të imponuar një axhendë politike".

Komisioni Evropian në raportin e tij të vitit 2025 për Maqedoninë e Veriut vëren se "Kërcënimet hibride mbeten një rrezik për Maqedoninë e Veriut, kryesisht përmes ndërhyrjeve të jashtme dashakeqe, përdorimit të instrumenteve ekonomike të pushtetit, përdorimit të instrumenteve në sektorin e informacionit dhe sulmeve kibernetike ndaj infrastrukturës së TIK-ut." Pavarësisht këtyre treguesve, në debatin publik vendas, instrumentet ekonomike të lartpërmendura shihen kryesisht përmes prizmit të bashkëpunimit, pra si një fenomen neutral ose thjesht zhvillimor. Qëllimi i këtij studimi është të sfidojë këtë supozim dhe të shqyrtojë se si instrumentet ekonomike - duke përfshirë investimet strategjike, marrëveshjet e privatizimit, kreditë për infrastrukturën dhe varësinë nga energjia - mund të bëhen kanale për ndikim të huaj në Maqedoninë e Veriut dhe cilat janë pasojat e zbatimit të tyre.

Duhet theksuar se studimi nuk synon të kundërshtojë investimet e huaja dhe bashkëpunimet strategjike, por më tepër të nxjerrë në pah rastet që mund të krijojnë hapësirë për ndikime të padëshiruara duke anashkaluar rregulloret ligjore të vendosura në vend dhe praktikat e qeverisjes së mirë. Studimi synon të arrijë te politikëbërësit në Maqedoninë e Veriut dhe BE-në, analistët dhe studiuesit mbi kërcënimet hibride dhe ekonomike, organizatat e shoqërisë civile që monitorojnë transparencën, korrupsionin dhe ndikimin e huaj, gazetarët dhe mediat investigative, si dhe publikun e gjerë.

2. PYETJE KËRKIMORE

Ky studim rasti pyet: A ka raste në Maqedoninë e Veriut ku investimet e huaja dhe partneritetet strategjike kanë mundësuar ndikim ekonomik dhe politik në vend, dhe çfarë pasojash kanë këto raste për qeverisjen demokratike?

3. BURIMET/METODOLOGJIA

Analiza në masë të madhe mbështetet në raportime me burime të hapura dhe studime analitike, duke përfshirë raportet dhe kërkimet e medias (BBC Macedonian, Deutsche Welle, Meta.mk, Balkan Insight), studime akademike (ResearchGate, Universiteti i Lundit, CEPA), dokumente politikash (Komisioni Evropian, Parlamenti Evropian), raporte auditimi (Zyra Shtetërore e Auditimit të Maqedonisë së Veriut), analiza nga organizatat joqeveritare: Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup (IDSCS), German Marshall Fund (GMF), Fondacioni Konrad Adenauer, International Crisis Group.

Fokusi i kësaj analize është në katër raste të rëndësishme investimi në projekte të mëdha infrastrukturore dhe energjetike:

- Privatizimi i rafinerisë OKTA.
- Ndërtimi i një rrjeti gazsjellësish të lidhur me borxhin rus të kliringut.
- Autostradat e financuara nga kinezët (Milladinovc–Shtip dhe Kërçovë–Ohër).
- Projektet e Korridoreve 8 dhe 10d që realizohen nga konsorciumi Bechtel dhe Enka.

4. KËRCËNIMI I SOVRANITETIT ENERGJETIK

4.1. PRIVATIZIMI I RAFINERISË „OKTA"

Privatizimi i rafinerisë së naftës OKTA në vitin 1999 përfaqëson një nga shembujt më të hershëm dhe më domethënës të krijimit të hapësirës për ndikim të huaj ekonomik në Maqedoninë e Veriut. Ai erdhi pas një periudhe jashtëzakonisht të ndjeshme për vendin të shkaktuar nga embargoja greke në vitet 1994-1995, e cila lejoi krijimin e presionit psikologjik se Greqia mund të rivendoste sanksionet për shkak të mosmarrëveshjes për emrin. Situata e vështirë në të cilën u gjend Maqedonia e Veriut (atëherë Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë) u përdor për të tërhequr investime greke në kushte të diskutueshme që më vonë do të rezultonin të dëmshme për vendin.

E zbatuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë e udhëhequr nga Kryeministri Ljubço Georgievski, shitja e OKTA-s te kompania greke Hellenic Petroleum u formulua si një hap i domosdoshëm drejt liberalizimit të tregut dhe integrimit rajonal. Megjithatë, struktura e marrëveshjes së blerjes, e cila u mbajt sekret për një kohë të gjatë, zbuloi një model të varësisë asimetrike, krijimit të monopoleve dhe ekskluzivitetit juridik.

Rruga drejt marrëveshjes me OKTA-n u hap në janar të vitit 1999, me miratimin e një Ligji të ri për Privatizimin, i cili shfuqizoi procedurën standarde për shpalljen e një tenderi ndërkombëtar dhe lejoi negociata të drejtpërdrejta me blerësin. Në këtë rast, Qeveria negocioi vetëm me Hellenic Petroleum dhe përjashtoi nga loja të gjithë ofertuesit e tjerë të mundshëm. Në maj të vitit 1999, u arrit një marrëveshje blerjeje aksionesh, ose marrëveshje investimi, sipas së cilës kompania greke pagoi 32 milionë dollarë për blerjen e rafinerisë. Në korrik të vitit 1999, Parlamenti i Maqedonisë miratoi Ligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes Dypalëshe midis Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë për Ndërtimin dhe Menaxhimin e Naftësjellësit, pjesë integrale e së cilës është pikërisht marrëveshja e investimit për "Okta", por përmbajtja e kësaj marrëveshje nuk u bë publike.

Në vitin 2002, Gjykata Kushtetuese e shfuqizoi këtë Ligj, duke shpjeguar se marrëveshja e investimit për "Okta", e cila është pjesë integrale e marrëveshjes dypalëshe, "përmban një mori privilegjesh dhe përfitimesh për investitorin strategjik, të cilat u legalizuan me ratifikimin e marrëveshjes". (Gjykata Kushtetuese). Gjykata konstatoi se në fakt "shkelet parimi kushtetues i statusit të barabartë juridik të të gjitha subjekteve të tregut dhe vendoset një regjim i veçantë në lidhje me investitorin strategjik". Për më tepër, gjykata konstatoi se investitorit strategjik i njihet në mënyrë jokushtetuese e drejta e përjashtimit nga pagesa e taksave dhe detyrimeve të tjera publike, d.m.th. këto dispozita kushtetuese mohohen dhe se marrëveshja e investimit për "Okta", e cila është pjesë e Ligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes Dypalëshe midis Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë, nuk është publikuar në përputhje me ligjin para se të hyjë në fuqi.

Publiku mësoi më pas se qeveria ishte zotuar t'i ofronte kompanisë greke një sërë lehtësirash tatimore dhe doganore, një pozicion monopoli në tregun e naftës, si dhe një blerje të garantuar vjetore prej 500,000 ton naftë për një periudhë prej 20 vitesh. Më vonë, ekspertët pohuan se shteti kishte marrë përsipër detyrime që nuk mund t'i përmbushte sepse "Maqedonia e Veriut nuk mund të konsumojë realisht kaq shumë naftë, pasi të gjitha termocentralet punojnë me gaz natyror". (Deutsche Welle). Për shkak të pamundësisë për të përmbushur detyrimet e marra sipas kontratës për blerjen e sasive të tilla të naftës, ose më saktë, për shkak të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, vendi u padit dy herë në Gjykatën e Arbitrazhit në Paris. Në vitin 2007 dhe 2022, gjykata vendosi në favor të kompanisë greke në të dyja rastet dhe Maqedonia e Veriut duhej të paguante dëmshpërblim në shumën prej 40 milionë eurosh dhe 21.4 milionë eurosh, ose një shumë totale prej 61.4 milionë eurosh. (Meta.mk)

Vitet e fundit, ka pasur disa nisma për të filluar procedurat e përgjegjësisë penale kundër individëve që i kanë shkaktuar dëm shtetit duke lidhur një marrëveshje antikushtetuese me kompaninë greke. Komisioni Antikorrupsion në vitin 2003 i paraqiti Prokurorisë një iniciativë për të filluar procedurë penale për këtë rast, duke vlerësuar se bëhet fjalë për një "akt korruptiv". Megjithatë, edhe pse procedura u hap, nuk pati kurrë një epilog sepse, siç deklaroi prokurori publik i atëhershëm Aleksandar Përçevski: "Prokuroria kërkoi dokumente shtesë për 'OKTA' nga disa institucione, por nuk i mori ato, prandaj rasti për 'OKTA' mbeti në procedurën para-hetimore". (BBC Macedonian, Transparency international)

4.1.1. PASOJAT EKONOMIKE DHE POLITIKE

Edhe pse privatizimi i OKTA-s diskutohet shpesh në terma ekonomikë, rëndësia e tij politike qëndron në mënyrën se si e kufizoi politikën energjetike të vendit gjatë një periudhe tensionesh të mprehta diplomatike me Greqinë. Kur bëhet fjalë për pasojat ekonomike - marrëveshja kufizoi konkurrencën duke shtypur mundësinë e importimit të karburanteve alternative dhe kështu shtrembëroi tregun vendas. Përveç kësaj, marrëveshja shkaktoi një barrë të konsiderueshme fiskale dhe taksash për qytetarët.

Më e rëndësishmja, "një pjesë e madhe e sovranitetit energjetik të Maqedonisë, në fakt, iu transferua një kompanie nga Greqia fqinje, një vend me të cilin Maqedonia ka disa çështje politike të pazgjidhura". (Grupi Ndërkombëtar i Krizave). Një nga çështjet kryesore të pazgjidhura midis dy vendeve në atë kohë ishte sfida e Greqisë ndaj emrit të atëhershëm kushtetues të shtetit - Republika e Maqedonisë, gjë që rezultoi në një embargo ekonomike dhe presion për pranim në Kombet e Bashkuara nën referencën e përkohshme Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (FYROM).

Në fakt, mosmarrëveshja për emrin midis dy vendeve përkoi me një varësi energjetike që kufizoi autonominë negociuese të Maqedonisë. Në terma institucionalë, marrëveshja ilustron se si ndikimi i huaj ekonomik mund të kodifikohet përmes marrëveshjeve ligjore detyruese që zgjasin më

shumë se ciklet politike. “OKTA” është një shembull se si privatizimi strategjik mund të funksionojë si një kanal i ndikimit politik pa shtrëngim të hapur. Kjo përputhet me konceptin e “pushtetit strukturor” që nënkupton se marrëveshjet ekonomike mund të formësojnë gamën e opsioneve politikisht të realizueshme dhe tezën se privatizimi dhe kontratat jotransparente mund të shërbejnë si leva të ndikimit politik. (CIPE, States and markets).

4.1.2. NDËRTIMI I NJË TUBACIONI GAZI DHE INVESTITORËT E NDËRMJETËM NGA RUSIA

Ndikimi ekonomik rus në Maqedoninë e Veriut ndërmjetësohet kryesisht përmes sektorit të energjisë. Maqedonia e Veriut është një nga vendet e pakta në Evropë që është plotësisht e varur nga gazi rus, të cilin e blen nga kompania shtetërore ruse Gazprom, duke e bërë atë të cenueshme dhe të ndjeshme ndaj ndikimit nga aspekti energjetik. (Balkan Insight). Gazi rus importohet nëpërmjet Bullgarisë, domethënë nëpërmjet pikës së ndërlidhjes Qustendill - Zhidilovo, ku janë të lidhura sistemet e transmetimit të gazit natyror maqedonas dhe bullgar.

Një rast i spikatur që hapi polemika në lidhje me ndikimin e mundshëm rus daton që nga viti 2010, kur qeveria maqedonase e udhëhequr nga kryeministri i atëhershëm Nikola Gruevski vendosi të zgjidhte borxhin e kliringut të Rusisë ndaj Maqedonisë së Veriut nga epoka sovjetike përmes një marrëveshjeje që do të përdorte paratë për të ndërtuar një tubacion gazi në territorin maqedonas. Sipas njoftimit nga Ministria e Financave, Maqedonia do të merrte 60 milionë dollarë amerikanë sipas marrëveshjes, të cilat do të përdoren për të zbatuar projektin e gazifikimit të vendit. Projekti u hartua publikisht nga të dyja palët, maqedonase dhe ruse, si një formë bashkëpunimi ekonomik dhe zgjidhjeje të borxhit (Russia beyond, Ambasada e Federatës Ruse në Maqedoninë e Veriut).

Megjithatë, hetimet pasuese ngritën pyetje në lidhje me strukturën financiare dhe ligjore të marrëveshjes. Në vitin 2018, Prokuroria Speciale Publike hapi një hetim të quajtur “Dhuratë”, në të cilin të dyshuar ishin ish-ministrat e Financave dhe të Transportit dhe Lidhjeve, Zoran Stavreski dhe Mile Janakieski, si dhe Krste Miladinov, drejtor i kompanisë shtetërore “Resurset Energjetike të Maqedonisë” AD Shkup. “Sipas PSP-së, ata qëllimisht përdorën pozicionin dhe autoritetin e tyre zyrtar për të përfituar përfitime të paligjshme pronësore në shumën prej 2,008,877,000 denarë (gati 33 milionë euro) për kompaninë ruse OAD ‘Stroytransgas’ nga Moska dhe shkaktuan dëme në Buxhetin në të njëjtën shumë.” (Radio Evropa e Lirë). Sipas hetimit: “Stavreski dhe Janakieski ishin përfaqësues të autorizuar për zbatimin e marrëveshjes ndërqeveritare, të lidhur më 19 qershor 2010 në Shën Petersburg midis Qeverive të Republikës së Maqedonisë dhe Federatës Ruse për rregullimin e detyrimeve të ish-BRSS ndaj ish-RSFJ-së në fushën e detyrimeve ndaj Maqedonisë. Sipas PSP-së, ata më parë kishin një studim mbi koston e seksionit Kleçovcë - Shtip, dhe megjithëse ishin të vetëdijshëm se çmimi real ishte shumë më i ulët se ai i rënë dakord me palën ruse, ata e pranuan atë.” Gjegjësisht, sipas studimit, kostoja e ndërtimit të seksionit do të ishte midis 30 dhe 35 milionë euro.

Më vonë, Prokuroria Publike, e cila i mori përsipër rastet nga PSP-ja, vazhdoi me këtë hetim, por procedura nuk pati epilog, me shpjegimin se “Prokuroria ende pret përgjigje nga Rusia” (Vistinomer, Meta.mk).

4.2. RASTI ME SERGEJ SAMSONENKO

Përtej energjisë dhe infrastrukturës, ndikimi rus manifestohet edhe përmes aktiviteteve të biznesmenëve të shquar që veprojnë në Maqedoninë e Veriut. Kjo theksohet nga raporti i Qendrës për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare mbi ndikimin rus në Evropën Lindore, i titulluar „Manuali i Kremlinit“. Dokumenti thotë se “një aspekt tjetër është ndikimi më i gjerë ekonomik, i cili nuk

kufizohet vetëm në sektorin e energjisë. Nëse ndikimi politik rus synon të shfrytëzojë dobësitë në shoqëritë e Evropës Qendrore dhe Lindore dhe të gërryejë institucionet liberale, atëherë ndikimi ekonomik rus kërkon të manipulojë dinamikën e tregut sektorial dhe të shfrytëzojë boshllëqet në qeverisje për të gjeneruar fitime të padrejta dhe për të ndikuar në vendimmarrjen kombëtare."

Grupi polak i ekspertëve „Qendra për Mendim Politik" e thekson Sergej Samsonenkon si një nga shembujt specifikë të ndikimit të biznesit rus në Maqedoninë e Veriut, investimet e të cilit në biznese dhe sporte të shumta i kanë sjellë atij një profil të spikatur publik.

"Edhe pse nuk është një aktor formal shtetëror i Rusisë, Samsonenko mishëron modelin e kapitalit privat që përputhet me interesat shtetërore duke ndikuar në elitat lokale dhe duke formësuar diskursin publik. Samsonenko është një milioner me origjinë ruse, i cili mbërriti në Maqedoninë e Veriut në vitin 2006, kurse aktivitetet e tij kryesore janë bastet (BetCity Balkans) dhe klubet sportive (klubi i futbollit dhe ekipi i hendbollit Vardar). Samsonenko ka marrëdhënie shumë të mira me elitën politike të afërt me ish-kryeministrin Nikola Gruevski dhe VMRO-DPMNE, si dhe me kryeministrin aktual Zoran Zaev (SDSM), thuhet në analizën e „Qendrës për Mendim Politik".

Prania e tij u zgjerua në ndërtim dhe hotelieri përmes objekteve të tilla si hoteli "Rusia" në Shkup dhe qendra sportive "Jane Sandanski". E gjithë kjo, së bashku me pronësinë e Qendrës Sportive Vardar, krijoi një ekosistem ku kapitali rus u bë i dukshëm në bërthamën urbane të Shkupit. Sidomos përmes Vardarit, i cili është marka më e madhe kombëtare sportive, dhe kështu arriti një lidhje emocionale me publikun. Kështu, ai praktikisht e mbrojti veten nga kritikat për bizneset që bënte me elitat politike të kohës.

Për më tepër, Ambasada e Federatës Ruse në Maqedoninë e Veriut njoftoi në vitin 2016 se Samsonenko ishte emëruar Konsull Nderi i Rusisë në Manastir. Sipas „Qendrës për Mendim Politik", duke qenë se ky është një individ që ka biznese në disa vende evropiane, është e vështirë të vlerësohet se deri në çfarë mase ai po mbronte interesat ruse në Maqedoninë e Veriut apo thjesht po mbronte modelin e tij të biznesit, "i cili bazohej në marrëdhënie të ngushta dhe jo transparente me ish-partinë në pushtet dhe elitën e saj politike".

Projektet që përfshijnë Rusinë shpesh janë mbështetur në marrëveshje dypalëshe dhe vendime qeveritare, në vend të tenderëve të hapur. Kjo praktikë rezonon me konceptin e "kapitalit gërryes", në masën që dobëson standardet e prokurimit dhe forcon vendimmarrjen diskrecionare. Në këtë kuptim, ndikimi rus vepron jo vetëm përmes mjeteve materiale, por edhe përmes erozionit institucional, duke krijuar kushtet për marrëveshje jotransparente.

Kjo u deklarua edhe nga grupi i kërkimit të politikave publike "Analitika", i cili doli me qëndrimin se: "të gjitha projektet e dakorduara midis Rusisë dhe Maqedonisë në sektorin e energjisë u bënë pas dyerve të mbyllura pa pjesëmarrjen e publikut, në shkelje të Konventës së Aarhusit, të cilën Maqedonia e ka ratifikuar, dhe ligjet që favorizojnë kompanitë ruse u miratuan me procedurë të shkurtuar. Është e qartë se projektet e dakorduara i sjellin dobi Rusisë, jo Maqedonisë" "(Analitika).

Ata theksojnë se "Maqedonia është shumë e ndjeshme dhe siguria e saj energjetike nuk është mjaftueshëm e qëndrueshme sepse është e varfër në burimet e veta dhe varet kryesisht nga importet, të cilat shfrytëzohen nga vende më të fuqishme dhe të pasura me burime."
Në fakt, rëndësia strategjike e infrastrukturës së gazit shtrihet përtej dobisë së saj ekonomike. Kontrolli mbi rrjedhat e energjisë krijon potencialin për ndikim politik përmes çmimeve, kushteve të furnizimit dhe varësisë kontraktuale afatgjatë.

5. KAPITALI GËRRYES DHE MINIMI I LEGJISLACIONIT TË PROKURIMEVE PUBLIKE

5.1. KREDI NGA KINA PËR NDËRTIMIN E AUTOSTRADAVE NË MAQEDONINË E VERIUT

Kina është e pranishme në Republikën e Maqedonisë së Veriut kryesisht me projekte të sektorit publik, duke përfshirë kontrata publike dhe ndihmë zhvillimore - grante dhe kredi preferenciale (Konrad Adenauer). Angazhimi i rëndësishëm ekonomik i Kinës me Maqedoninë e Veriut filloi në fillim të viteve 2010, duke përkuar me pranimin e vendit në Platformën e Bashkëpunimit Kinë-Evropë Qendrore dhe Lindore (CEE). Periudha pas vitit 2012 shënoi një ndryshim cilësor nga tregtia në financimin e infrastrukturës të mbështetur nga Kina. Ky tranzicion pasqyroi strategjinë më të gjerë të Pekinit në kuadër të iniciativës "Një Brez, Një Rrugë" (Rruga e Mëndafshit) - korridoret e infrastrukturës si instrumente të lidhjes gjeoekonomike dhe ndikimit politik.

Maqedonia e Veriut është bërë vendi i parë në rajon që përdor linjën e kredisë prej 10 miliardë dollarësh nga Banka EXIM e Kinës për ndërtimin e infrastrukturës në Evropës Qendrore dhe Lindore. U zgjodhën dy segmente autostradash: Milladinovc-Shtip dhe Kërçovë-Ohër, me një gjatësi totale prej afërsisht 100 kilometrash. Studimi i Universitetit të Lundit me titull „North Macedonia's response to hybrid threats and malign foreign influence and interference" vëren se huadhënësit evropianë i kishin refuzuar më parë këto projekte si ekonomikisht të paqëndrueshme, gjë që rriti atraktivitetin e financimit kinez.

Qeveria maqedonase ia dha ndërtimin kompanisë shtetërore kineze Sinohydro Corporation Limited (Sinohydro) me seli në Pekin, pas negociatave dhe procedurave që, sipas një studimi nga Instituti për Demokraci Societas Civilis - Shkup (IDSCS) nuk ishin transparente: "Kishte një mungesë të plotë të procedurave transparente dhe konkurruese të prokurimit publik në kontratat me Sinohydro. Këto kontrata u bënë përmes negociatave të drejtpërdrejta dhe të fshehta midis qeverive kineze dhe maqedonase."

Marrëveshja për Bashkëpunim Ekonomik dhe Teknik në Fushën e Infrastrukturës midis Qeverive të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës Popullore të Kinës më pas u bë pjesë e legjislacionit kombëtar të Maqedonisë së Veriut përmes miratimit të Ligjit për Zbatimin e Projekteve të Infrastrukturës për Ndërtimin e Seksionit Rrugor Milladinovc - Shtip dhe Seksionit Rrugor Kërçovë - Ohër në vitin 2013, i cili më pas u ndryshua për të zgjatur punimet e ndërtimit.

Konkretisht, segmenti Shtip-Milladinovc u përfundua vetëm me një vonesë të vogël dhe pa polemika të mëdha, por ndërtimi i autostradës Kërçovë-Ohër nuk vazhdoi pa probleme dhe në përputhje me afatet dhe shumat e parashikuara dhe të kontraktuara, duke ngritur pyetje serioze në lidhje me planifikimin, përgatitjen dhe ekzekutimin e projektit (Lund University). Edhe pse ndërtimi filloi në maj të vitit 2014, mangësitë serioze strukturore në lidhje me dokumentacionin e projektit dhe procedurat administrative shkaktuan një vonesë serioze edhe pse projekti fillimisht ishte planifikuar të përfundonte në vitin 2019.

Prokuroria Speciale Publike gjithashtu kreu një hetim për këtë rast nën emrin "Trajektorja", e cila ngriti një aktakuzë kundër kryeministrit Nikola Gruevski dhe tre zyrtarëve të tjerë të lartë shtetërorë në vitin 2017. Megjithatë, për shkak të ndryshimeve në Kodin Penal, veprat u parashkruan në vitin 2023 dhe akuzat u tërhoqën (360 shkallë).

Po të njëjtin vit, Enti Shtetëror i Auditimit, pas kontrollit të punës së Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore, vuri në dukje një sërë mospërputhjesh që çuan në zgjatjen dhe rritjen e kostove për ndërtimin e segmentit autostradë Kërçovë-Ohër, duke përfshirë:

- Në periudhën nga maji 2018 deri në dhjetor 2021, u bënë pesë ndryshime në kontratën bazë për ndërtimin e segmentit rrugor, gjatë të cilave u lidhën anekset e kontratës.
- Me anekset, afati për përfundimin e ndërtimit u zgjat me 6 vjet, d.m.th. ndërtimi u përcaktua të përfundonte deri në dhjetor 2023, dhe për kryerjen e punimeve shtesë dhe të paparashikuara, vlera e kontratës bazë u rrit me 187 milionë euro, për shkak të së cilës vlera e ndërtimit të segmentit rrugor arriti në një total prej 598 milionë eurosh.
- Në këtë mënyrë, kostoja e rënë dakord e një kilometri segmenti rrugor nga 7.3 milionë euro u rrit me 44% dhe arrin në 10.5 milionë euro (EShA).

Në fakt, autostrada Kërçovë-Ohër nuk ka përfunduar ende në kohën e shkrimit të këtij botimi (shkurt 2026). Me një marrëveshje të re aneks, të tetën me radhë, afati i ndërtimit u zgjat deri në maj 2027, dhe çmimi u rrit me 186 milionë euro shtesë.

5.1.1. PASOJAT EKONOMIKE DHE POLITIKE

Kredia kineze është bërë një lloj precedenti në legjislacionin maqedonas për shkak të numrit rekord të anekseve të marrëveshjes fillestare. Përveç kësaj, sekreti i negociatave për dhënien e kredisë është problematik, gjë që ngre dyshime për vonesë të qëllimshme të ndërtimit në dëm të buxhetit të shtetit dhe qytetarëve maqedonas.

Sipas IDSCS: “Kapitali gërryes i ndërthurur në investime të tilla minon besimin në institucione, dobëson sundimin e ligjit, nxit mungesën e transparencës dhe synon të imponojë pushtet monopoli mbi segmente të gjera të ekonomisë.”

Edhe pse kushtet e kredisë kineze për ndërtimin e infrastrukturës rrugore në Maqedoninë e Veriut ishin mjaft konkurruese dhe të favorshme, me norma interesi fikse prej 2% dhe një periudhë shlyerjeje 20-vjeçare që përfshin një periudhë mospagimi 5-vjeçare, të gjitha marrëveshjet e kredisë të lidhura me Bankën Kineze EXIM përmbajnë dispozita që i vënë të gjitha palët e interesuara në një pozicion inferior, siç është një klauzolë për ndërprerje të njëanshme të marrëveshjes, anulim të kredisë dhe një kërkesë për shlyerje të menjëhershme në një gamë të gjerë rrethanash (Estima). Avantazhi kryesor politik për Kinën në kreditë e mëdha për infrastrukturën është varësia në çështjet e jashtme dhe vendimmarrjen në emër të vendeve përfituese (Journal of Liberty and International Affairs). Maqedonia e Veriut nuk bën përjashtim nga modeli standard i marrëveshjeve kineze të kredisë. Në këtë kontekst, projekti i ndërtimit të autostradës lidh Maqedoninë e Veriut me Kinën në një mënyrë asimetrike që i jep Kinës një avantazh të rëndësishëm në marrëdhëniet dypalëshe (Lund University).

Lidhur me interesin gjeostrategjik të Kinës në Maqedoninë e Veriut dhe hapësirën për ndikim ekonomik, duhet theksuar se Maqedonia e Veriut shtrihet në boshtin e transportit që lidh portin e Pireut në Greqi, i cili është nën kontrollin kinez, me Evropën Qendrore. Kështu, investimet në infrastrukturë në autostradat maqedonase i shërbejnë si logjistikës tregtare ashtu edhe pozicionimit gjeopolitik të Kinës.

5.2. RASTI "BECHTEL DHE ENKA": RECETË E VJETËR, LOJTARË TË RINJ

Zakonisht, kur flitet për FIMI-n dhe veçanërisht për ndikimin ekonomik të huaj në rajonin e Ballkanit Perëndimor, Rusia dhe Kina përmenden si aktorët kryesorë. Prandaj, rasti i "Bechtel dhe Enka", një konsorcium amerikano-turk që u përzgjodh nga Qeveria e udhëhequr nga Kryeministri Zoran Zaev për të ndërtuar seksione autostradash të Korridoreve 8 dhe 10d në Maqedoninë e Veriut, duke anashkaluar përsëri rregulloret ekzistuese dhe praktikat e mira për prokurimin publik, është specifik.

Konkretisht, siç është konstatuar nga Enti Shtetëror i Auditimit në korrik të vitit 2021, me propozim të Qeverisë, Parlamenti miratoi Ligjin për Përcaktimin e Interesit Publik dhe Emërimin e një Partneri Strategjik për Zbatimin e Projektit për Ndërtimin e Korridorit 8 të Infrastrukturës (seksioni: Tetovë - Gostivar - Bukojçan dhe Projekti i Autostradës Trebenishtë - Strugë - Qafëthanë) dhe Korridorit 10d (seksioni i Autostradës Prilep - Manastir) në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në bazë të të cilit konsorciumi Bechtel dhe Enka u emërua partner strategjik, ndërsa NP për Rrugët Shtetërore u emërua investitor në ndërtimin e korridoreve.

Në mars të vitit 2023, u nënshkrua një marrëveshje ndërtimi midis partnerit strategjik, investitorit dhe Ministrisë së Transportit dhe Komunikacionit, në emër dhe për llogari të Qeverisë, në lidhje me menaxhimin e projektimit, ndërtimit të punimeve dhe përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm të projektit në lidhje me Korridorin 8 dhe Korridorin 10d. Parashikohet që burimet financiare për zbatimin e projekteve do të sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në formën e një transferimi për investitorin ose "nga çdo burim tjetër në përputhje me ligjet në fuqi" (EShA).

Ky është një nga investimet më të mëdha në infrastrukturën rrugore në vend, me një vlerë totale kontraktuale prej 1.3 miliardë eurosh ose afërsisht 80.2 miliardë denarë, në një procedurë që u mbulua përsëri nga jotransparenca dhe që vazhdoi edhe pas ndërrimit të qeverisë, me shpjegimin se ishte sekret shtetëror (MIA). Për më tepër, një numër ligjesh ekzistuese u ndryshuan për të lehtësuar zbatimin e projekteve (Prizma).

Në këtë rast, Fondi Kombëtar për Demokraci nga Shtetet e Bashkuara dhe Instituti për Demokraci "Societas Civilis" publikuan një dokument politikash në të cilin vërehen një sërë dështimesh sistemike: "Përballë një bllokade të mundshme në Parlament, pas propozim-amendamenteve të paraqitura në disa ligje në vitin 2023, me qëllim harmonizimin me Ligjin për Korridoret 8 dhe 10d, Qeveria vendosi të përdorë një flamur evropian për këto propozime. Ky modalitet përdoret për të harmonizuar legjislacionin vendas me rregullat e BE-së dhe lejon një procedurë më të shpejtë në Parlament. Baza për këtë është fakti se bëhet fjalë për harmonizim, kështu që hapësira për devijim nga legjislacioni evropian është më e vogël, kështu që Parlamenti mund të diskutojë kryesisht midis refuzimit dhe pranimit të harmonizimit, dhe në një masë shumë më të vogël për ndryshimin e rregullave.

Megjithatë, dokumenti thotë se projektligjet e paraqitura nuk i referohen harmonizimit specifik me legjislacionin evropian në fushën përkatëse. Të gjitha projekt-amendamentet e ligjeve i referohen Rregullores (BE) nr. 1315/2013 të Parlamentit Evropian dhe amendamenteve të saj, të cilat përcaktojnë përkufizime dhe standarde për infrastrukturën e transportit në Bashkimin Evropian, si dhe përkufizimet e korridoreve në të cilat do të punohet.

"Rregullorja në fjalë nuk përmban përmbajtje që rregullon fushat e marrëdhënieve të punës, ndërtimit dhe planifikimit urban, si dhe mbrojtjen e mjedisit. Duke vepruar kështu, Qeveria iu referua një rregulloreje evropiane të parëndësishme, duke i shënuar ndryshimet e propozuara me një flamur evropian", thuhet në këtë dokument politikash.

Për më tepër, IDSCS dhe NED bëjnë me dije se pavarësisht kërkesës nga Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit për të vënë veton ndaj rregullores së kontestuar, Presidenti i vendit nënshkroi Ligjin për Korridoret 8 dhe 10d në vitin 2021, duke shpjeguar se asnjë deputet në Parlament nuk votoi kundër tij. "Presidenti duhet të kishte vlerësuar të gjitha lëshimet e mëparshme, mungesën e transparencës, mungesën e konsultimeve dhe procedurave të përshpejtuara, si gjatë miratimit të Ligjit për Korridoret 8 dhe 10d, ashtu edhe gjatë ndryshimeve në ligjet e lartpërmendura në vitin 2023, të miratuara me qëllim harmonizimin e tyre" (IDSCS, NED).

Dokumenti vë në dijeni se rasti i miratimit të Ligjit për Korridoret 8 dhe 10d tregon qartë se si katër pika kontrolli në proces vazhdimisht dështojnë të sigurojnë integritet në vendimmarrje: "Interesi privat i konsorciumit hyn pa pengesa në procesin e vendimmarrjes në Qeveri, ku neglizhohen si ligjet ashtu edhe rregullorja e procedurës. Kuvendi nuk e përmbush rolin e tij kontrollues dhe konsultativ, por përkundrazi, duke neglizhuar rregulloren e vet të procedurës, lejon mangësi të konsiderueshme në miratimin e ligjeve të diskutuara. Pika e fundit, në rrugën nga një ide deri te hyrja në fuqi e një ligji, Presidenti neglizhon të gjitha mangësitë e akumuluara më parë dhe nuk e përdor rolin e tij si kundërpeshë në procesin e vendimmarrjes."

6. PËRFUNDIM

Ky studim ka treguar se manipulimi i informacionit dhe ndërhyrja e huaj (FIM) në Maqedoninë e Veriut nuk kufizohet vetëm në media dhe operacione hibride, por kryhet edhe përmes instrumenteve ekonomike që kanë efekte politike dhe institucionale afatgjata. Përmes analizës së rasteve të privatizimit të OKTA-s, projekteve të gazsjellësit të lidhur me Rusinë, kredive kineze të infrastrukturës dhe projekteve të zbatuara nga Bechtel dhe Enka, përcaktohet se angazhimet ekonomike mund të funksionojnë si kanale ndikimi, veçanërisht kur zbatohen përmes kontratave jotransparente, përjashtimeve nga procedurat standarde të prokurimit publik dhe regjimeve të veçanta ligjore.

Gjetjet empirike sugjerojnë se këto mekanizma prodhojnë tre pasoja kryesore. Së pari, ato krijojnë varësi strukturore - në sektorin e energjisë përmes pozicioneve monopol ose kuazi-monopoli, dhe në infrastrukturë përmes detyrimeve financiare afatgjata që kufizojnë autonominë fiskale dhe politike të shtetit. Së dyti, ato nxisin erozionin institucional, pasi ato realizohen përmes anashkalimit të prokurimit publik, zbatimit selektiv të ligjeve dhe mbikëqyrjes së dobësuar parlamentare dhe gjyqësore. Së treti, ato ndikojnë në proceset politike në mënyrë indirekte, duke formësuar gamën e politikave të mundshme publike dhe duke krijuar marrëdhënie asimetrike pushteti midis shtetit marrës dhe aktorëve të huaj.

Një kontribut veçanërisht i rëndësishëm analitik i këtij studimi është kapërcimi i dikotomisë midis kapitalit të huaj "të mirë" dhe "të keq". Rasti i "Bechtel dhe Enka" tregon se edhe investimet e lidhura me partnerët perëndimorë mund të prodhojnë efekte të ngjashme me ato të të ashtuquajturit kapital gërryes, nëse ato zbatohen në kushte jotransparence, përjashtimesh ligjore dhe mbikëqyrjeje të kufizuar demokratike. Prandaj, problemi nuk qëndron vetëm në origjinën gjeopolitike të kapitalit, por në modelin e qeverisjes dhe kuadrin institucional në të cilin është i ngulitur.

Implikimet për politikat publike janë të rëndësishme. Nëse Maqedonia e Veriut dëshiron ta forcojë qëndrueshmërinë e saj ndaj ndikimit të huaj, është e domosdoshme të forcohet korniza e brendshme e qeverisjes përmes së cilës projekte të tilla negociohen, miratohen dhe zbatohen.

Kjo nënkupton rikthimin e përparësisë së prokurimeve publike transparente dhe konkurruese, forcimin e mbikëqyrjes parlamentare, gjyqësore dhe të auditimit mbi projektet strategjike ekonomike, si dhe përfshirjen e vlerësimeve të rrezikut nga ndikimi i huaj në shqyrtimin e investimeve të mëdha. Përfshirja e këtyre masave është gjithashtu e rëndësishme sepse ato tregojnë mësimin kryesor që del nga rastet e analizuara në këtë studim: kur projekte të mëdha ekonomike realizohen pa transparencë, mbikëqyrje dhe llogaridhënie, ato lehtësisht mund të shndërrohen në instrumente të ndikimit politik.

Së fundmi, ky studim sugjeron që FIMI duhet të kuptohet si një fenomen shumëdimensional, në të cilin instrumentet ekonomike janë po aq të rëndësishme sa operacionet e informacionit. Në kontekstin e Maqedonisë së Veriut, angazhimet ekonomike të huaja nuk janë domosdoshmërisht problem në vetvete, por ato bëhen të rrezikshme kur kryhen pa transparencë, pa debat publik dhe pa mekanizma të fortë të kontrollit institucional. Prandaj, ndryshimi midis bashkëpunimit të orientuar drejt zhvillimit dhe pranisë ekonomike të orientuar drejt ndikimit nuk është në burimin e kapitalit, por në cilësinë e qeverisjes së brendshme.

7. BURIMET:

1. Institute of Communication Studies (2025) Foreign Information Manipulation and Interference in the Republic of North Macedonia. Skopje: Institute of Communication Studies.
2. Constitutional Court of the Republic of Macedonia (2002) Decision to Repeal the Law on Ratification of the Bilateral Agreement between the Republic of Macedonia and the Republic of Greece on the Construction and Management of an Oil Pipeline. Skopje: Constitutional Court of the Republic of Macedonia.
3. International Crisis Group (2002) Macedonia's Public Secret: How Corruption Drags the Country Down. Balkans Report No. 133. Brussels: International Crisis Group.
4. BBC News in Macedonian, Proceedings Concerning Responsibility for "OKTA".
5. Deutsche Welle, The "OKTA" Agreement Is History... But What About the Bills?
6. Official Gazette of the Republic of Macedonia (1999) Decree / Law on Ratification of the Bilateral Agreement between the Republic of Macedonia and the Republic of Greece on the Construction and Management of an Oil Pipeline. Skopje: Official Gazette of the Republic of Macedonia.
7. Center for International Private Enterprise, Corrosive & Constructive Capital Initiative. Washington, DC: CIPE.
8. Strange, S. (1988) States and Markets: An Introduction to International Political Economy. London: Pinter Publishers.
9. Meta.mk, The Prosecution Also under Scrutiny over the Compensation Ruling for "OKTA".
10. Meta.mk, We Will Again Pay Compensation Because of the Harmful "OKTA" Agreement - This Time EUR 21.4 Million.
11. Transparency International Macedonia (2007) Договорот за продажба на ОКТА може да се поништи. Skopje: Transparency International Macedonia.
12. Ministry of Finance (2010) Македонија и Русија го потпишаа договорот за клириншкиот долг. Skopje: Ministry of Finance.
13. Russia Beyond, Руска компанија за 75 милиони долари ќе изгради гасовод во Македонија.
14. Radio Free Europe (2018) СЈО отвори шест нови истраги – опфатени Бујар Османи, Зоран Ставрески, Игор Јанушев.
15. Embassy of the Russian Federation in North Macedonia, Sixth Session of the Intergovernmental Russian-Macedonian Commission for Trade, Economic, Scientific and Technical Cooperation.
16. Balkan Insight, Balkan Countries 'Still Heavily Dependent on Russian Gas'.
17. Truthmeter, Четири години „подарокот" од 33 милиони евра за рускиот гасовод сè уште е во истрага.
18. Center for Strategic and International Studies (2016) The Kremlin Playbook. Washington, DC: CSIS.

19. Vit, M., Russian Influence in Western Balkan and North Macedonia. Kraków: Ośrodek Myśli Politycznej.
20. Embassy of the Russian Federation in North Macedonia (2016) New Honorary Consul of Russia Appointed in Bitola. Skopje: Embassy of the Russian Federation in North Macedonia.
21. Analytica, Руската (гасна) врска – како Македонија ги склучуваше договорите. Skopje: Analytica.
22. Konrad Adenauer Stiftung, Местото на Северна Македонија во стратегијата на Кина за Западен Балкан.
23. 360 Degrees (2023) Измените на КЗ ја запреа и кривичната постапка за случајот „Траекторија“ – Груевски, Јанакиески и Пешевски нема да одговараат за кинеските автопати. Skopje: 360 Degrees.
24. Krstinovska, A. (2022) Втурнати во ќорсокак: заблудената верба во кинескиот корозивен капитал за изградбата на автопатите во Северна Македонија. Skopje: ESTIMA.
25. Krstinovska, A. (2022) China's Aid in the Western Balkans: Supporting Development, Undermining Good Governance. Prague: Association for International Affairs / CHOICE.
26. Daskalovski, Z. and Damjanovski, S. (2024) Psychological Defence and Strategic Resilience: North Macedonia's Response to Hybrid Threats and Malign Foreign Influence and Interference. Working Paper 2024:2. Лунд: Lund University Psychological Defence Research Institute.
27. Assembly of the Republic of North Macedonia (2021) Law on Determining the Public Interest and Nominating a Strategic Partner for the Implementation of the Project for the Construction of Infrastructure Corridor 8 (Section: Tetovo - Gostivar - Bukojchani and the Motorway Project Trebenishta - Struga - Qafasan) and Corridor 10d (Motorway Section Prilep - Bitola) in the Republic of North Macedonia. Skopje: Assembly of the Republic of North Macedonia.
28. Misha Popovikj (2023) Integrity in Decision-Making: Systemic Failures in the "Bechtel and Enka" Case. Skopje: Institute for Democracy "Societas Civilis" - Skopje.
29. MIA (2024) Nikoloski: Can't declassify Bechtel-Enka contract without their approval, goal is to maximize the kilometers of motorway we get. Skopje: Macedonian Informative Agency.
30. State Audit Office (2021) Конечен извештај на Државниот завод за ревизија на ЈП Државни патишта. Skopje: State Audit Office.
31. Dimeska, F. and Jakimova, J. (2023) За изградбата на коридорите на „Бехтел и Енка“ ќе се менуваат девет закони.

